



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.709/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua (PZAP)**, me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Kymete Kicaj anëtare, duke vendosur përkitazi me ankesat e Muhamet Kurtaj, kandidat për kuvend komunal nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Gllgocit të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me objekt të çështjes keqpërdorim i votave, për Zgjedhje/. Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2021, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**HUDHEN** të palejuara ankesat Anr.709/2021, Anr.710/2021, Anr.711/2021 dhe Anr.712/2021 të gjitha të datës 21.10.2021, të paraqitura nga Muhamet Kurtaj, kandidat për kuvend komunal nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Gllgocit, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të keqpërdorimit të votave ne Qendra te Votimit, me nr.0320E, 0321E, 0317E dhe 0323E për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

#### **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 21.10.2021 ka pranuar ankesat Anr.709/2021, Anr.710/2021, Anr.711/2021 dhe Anr.712/2021 nga Muhamet Kurtaj, kandidat për kuvend komunal nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Gllgocit, më të cilën theksohet se në Qendrën e Votimit 0321E, po ashtu në fshatin Llapushnik QV 0317E dhe fshatin Terdec QV 03023E ka hasur parregullsi dhe keqpërdorim të votave ku në këto qendrat të votimit pretendon se ka më shumë vota se sa që i kanë dalur në formular e për këtë deklaroi se ka familjarë që mund të dëshmojnë se kanë votuar të njëjtin.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesave, gjeti se

## **Ankesat janë të palejuara**

Paneli, pasi ka vlerësuar pretendimet në ankesat Anr.709/2021, Anr.710/2021, Anr.711/2021 dhe Anr.712/2021 të cilat për nga përmbajtja janë të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, paraqitës i ankesave është Muhamet Kurtaj, kandidat për kuvend komunal nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Gllogocit dhe po ashtu të njëjtat janë paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduara në ankesat e paraqitura përkitazi me parregullsitë, për faktin se shkeljet që ndërliidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ti hedhë si të parakohshme ankesat e ankuesit. Hedhja e ankesave të Muhamet Kurtaj, kandidat për kuvend komunal nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Gllogocit nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

**Anr.709/2021 më datën 22.10.2021**



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*